URDHËR
Nr. 387, datë 12.6.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 360, DATË 5.9.2013, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, "PËR MËNYRËN E NJOFTIMIT ELEKTRONIK TË AKTEVE GJYQËSORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 141, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 360, datë 5.9.2013, të ministrit të Drejtësisë, "Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve gjyqësore" bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pas fjalës "pala" shtohet togfjalëshi "ose personi i tretë".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Njoftimi elektronik bëhet me mjete të komunikimit elektronik që mundësojnë marrjen e njoftimit në adresën e postës elektronike apo numrin e kontaktit të deklaruar nga vetë pala apo personi i tretë. Punonjësi i gjykatës dokumenton dërgimin dhe marrësi duhet të konfirmojë marrjen e njoftimit brenda 5 ditësh. Me kalimin e këtij afati, njoftimi konsiderohet i kryer.".

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Njoftimi elektronik i paditësit, të paditurit apo përfaqësuesve të tyre bëhet kur, sipas rastit, në kërkesëpadi, deklaratën e mbrojtjes, si dhe në mjetet e ankimit janë paraqitur të dhënat elektronike të kontaktit, si dhe deklarata e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.".

4. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtjen si vijon:

"4/1 Gjykata i kërkon personit të tretë konfirmimin e adresës dhe paraqitjen e të dhënave elektronike të kontaktit të tij apo përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, ku gjykata kryen njoftimet. Njoftimi elektronik i personit të tretë kryhet kur ai e ka pranuar përmes deklaratës së pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.".

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Në rast se vërtetohet nga punonjësi i gjykatës se pala, përfaqësuesi i saj, nëse ka një të tillë apo personi i tretë ka ndryshuar të dhënat elektronike të kontaktit dhe gjykata nuk është njoftuar për të dhënat e reja, në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 129 të Kodit të Procedurës Civile, pretendimet e tyre për pavlefshmërinë e njoftimit janë të papranueshme. Në këtë rast, njoftimi bëhet me shpallje publike, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.".

6. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"10. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.".

7. Kudo në tekstin e urdhrit fjalët "nëpunësi gjyqësor" zëvendësohen me fjalët "punonjësi i gjykatës".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja